



C.nr.201/2010

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, departamenti i per gjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minire Krasniqi, ne ceshtejn kontestimore te inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga Ferizaj [REDACTED] te cilin e perfaqeson me autorizim av. [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditurve [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], tani me adresë te panjohur, me pare nga Ferizaj, te cilin e perfaqeson perfaquesuesi I perkohshem av. [REDACTED] nga Ferizaj, per vertetim pronesie, ne shqyrtimin kryesor mbajtur me date 21.11.2016, ne pranine e paleve ndergjyqese merr kete:

A K T G J Y K I M
- në bazë të pohimit -

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj

VËRTETOHET se paditësi [REDACTED] ka të drejtën e pronësisë prej 3/6 te pjesë ideale të parceles kadastrale numer **336-10** te vendi quajtur "Ara te Dardha" ne siperfaqe prej 176 m² ZK Ferizaj dhe të drejtën e pronësisë të parceles kadastrale numer **342-12** e cila gjendet te vendi quajtur "Ara te dardha" ne siperfaqe prej 44 m² ZK Ferizaj, pjesa e pronesisë 1/1 dhe **OBLIGOHEN** te paditurit N. [REDACTED] D. [REDACTED] P. [REDACTED] T. [REDACTED] S. [REDACTED] M. [REDACTED] si dhe M. [REDACTED] R. [REDACTED] që paditesit t'ia njojin kete te drejte dhe lejojnë regjistrimin e te drejtave te tij mbi keto parcela ne regjistrat kadastral ne komunen e Ferizaj, nen kercenimin e permbarimin me force ne afat prej 15 ditesh, pas ploptefuqishmerise se ketij aktgjykimi.

OBLIGOHET paditesi qe te paguan taksen gjyqesore per aktgjykim ne shume prej 50.00€ , shpenzimet e ekspertit te gjeodezise ne shume prej 150.00€, si shpenzimet per perfaquesuesin e perkohshem te te paditurit ne shume prej 2.337.00€, pas pranimit te ketij aktgjykimi nen kercenimin e pasojave ligjore

A r s y e t i m i

Paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurve, për shkak te vertetimit te pronesise.

Gjykata lidhur me pretendimet e padise ka angazhuar perfaquesues te perkohshem per te perfaqsesuar interest e te paditureve ne kete procedure dhe nga procedimi i gjithmbarshem i fakteve dhe ceshtjeve te provave te nxjerra ka rezultuar se mes paleve nuk ishin kontestuese faktet me rendesi vendimtare per zgjidhjen e mosmarreveshjes, meqenese perfaquesuesi i perkohshem i te apditureve ka elaboruar gjendjen e provave te nxjerra nga ku ka kontatuar se nuk eshte kontestues pretendimi i paditesit perkitazi me vertetimine e te drejtave te tij mbi parcelat objekt kontesti.

Gjykata me qellim te vertetetimit te drejte te gjendjes se fakteve lidhur me parcelat ka angazhuar ekspertin e gjeodezise nga ku jane sqaruar te gjitha te dhenat gjeodezike dhe kadastrale per gjendjen parcelave objekt kontesti.




Meqenese se perfaqesuesi i perkohshem i te pditureve nuk ka kontestuar faktet vendimtare te ceshjes dhe ka pranuar faktin se paditesi ka blere parcelat respektivisht pjeset e parcelave objekt kontesti, ndersa ne anen tjeter gjykata ka vlerësuar se nuk ekzistojne pengesa ligjore nga nenit 148.2 te LPK-se, per marrjen e aktgjykit ne baze te pranimit ne kuptim te nenit 148 te LPK-se.

Gjykata ka obliguar paditesin per pagesen e takses gjyquesore per Aktgjykim ne baze te UA nr.2008/2 te KGJK-se, ndersa perkitazi me shpenzimet e procedures per perfaqesuesin e perkohshem ne baze te nenit 81 lidhur me nenin 453 te LPK-se.

Mbi bazen e parashtrimeve te mesiperme ehste vendsour si ne dispozitiv te ketij Aktgjyki.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
C.nr.201/2010 date 21.11.2016



KESHILLA JURIDIKE: Kunder aktgjyktimi eshte e lejuar ~~hesa~~ ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij , ne gjykaten e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

REPUBLICA E KOSOVËS  REPUBLICA KOSOVA
VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSENZA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,
FERIZAJ / UROŠEVAC

MB
21.01.2017

21.01.2017

